

L I G J
Nr.7538, datë 17.12.1991

**PËR NDRYSHIME NË LIGJIN NR.6298, DATË 27.3.1981 "PËR PROKURORINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

"Prokuroria është organ që bën ndjekje penale, mbron akuzën në gjyq dhe kontrollon zbatimin e ligjeve, në bazë të kompetencave të njohura nga dispozita kushtetuese dhe aktet e tjera ligjore".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Prokuroria është e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj. Ajo vepron vetëm në bazë të ligjit".

Neni 3

Në nenin 6 në paragrafin e parë dhe të dytë, pas fjalëve "të zonave" shtohen fjalët "dhe ushtarake".

Neni 4

Në nenin 7, paragrafi i parë, hiqen fjalët "përfshirë dhe njësitë e repartet ushtarake".

Në këtë nen, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Prokuroria ushtarake ushtron të drejtat e saj brenda kufijve tokësorë të njësisë përkatëse, të caktuar nga ministri i Mbrojtjes dhe Prokurori i Përgjithshëm".

Neni 5

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Prokurori ka këto detyra:

1. Kontrollon nëse aktet e nxjerra nga organet shtetërore përputhen me ligjet.
2. Kontrollon zbatimin e ligjeve:
 - a) në organet e administratës shtetërore;
 - b) në organet e rendit publik e të shërbimit, informativ kombëtar, për të siguruar ligjshmërinë në veprimtarinë e tyre;
 - c) në organet e hetuesisë dhe ato gjyqësore, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale e në Kodin e Procedurës Civile;
 - ç) në organet e ngarkuar për ekzekutimin e vendimeve penale.
3. Merr masa për zbatimin e ligjit të shkelur dhe vë përpara përgjegjësisë ligjore shkelësit".

Neni 6

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Prokurori merr pjesë në gjykimin e çështjeve penale si mbrojtës i akuzës, si dhe ka të drejtë të marrë pjesë në gjykimin e çështjeve civile".

Neni 7

Paragrafi i parë i nenit 20 ndryshohet si vijon:

"Protesta është akti, me anën e të cilit prokurori kërkon shfuqizimin ose ndryshimin e akteve të paligjshme të organeve shtetërore".

Neni 8

Nenet 2, 3, 4, 9, 10, 11/a, 12, 15, 16 paragrafi i katërt dhe 24, shfuqizohet.

Neni 9

Çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.99, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia